

Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj

PUNA DHE KOHA E LIRË

Fletore tematike
për nivelin e tretë

duk gjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.


PH Zürich



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

Puna dhe koha e lirë në vendin ku jetoj	5
1. Lexuesit e rinj shqiptarë.....	5
2. Gjuha shqipe - pasuri e përjetshme.....	8
3. Profesionet dhe parakushtet.....	10
4. Shkollat tona janë të ndryshme.....	13
5. Profesioni i ëndërruar.....	15
6. Mosmarrëveshje me babanë.....	17
7. Profesionet në atdhe dhe në vendet e tjera.....	19
Puna dhe koha e lirë në Atdhe	21
8. Jeta dhe puna në fshat dhe në qytet	21
9. Puna në ndërmarrjet publike dhe private.....	23
10. Koha për lojë.....	25
11. Folklori shqiptar.....	27
12. Lojëra të atdheut	29
13. Dalja në mbrëmje.....	31
14. Një vizitë në atdhe.....	34
Puna, koha e lirë dhe mediat	36
15. Truri elektronik	36
16. Veglat softuerike për internet.....	38
17. Të rinjtë dhe interneti	40
18. Ne dhe televizioni	42
19. Reklama dhe nxitja	44
20. Shqetësimet e një nxënëseje.....	46



PUNA DHE KOHA E LIRË NË VENDIN KU JETOJ

1. LEXUESIT E RINJ SHQIPTARË

Në shkollën shqipe të mësimin plotësues një grup i nxënësve dëshironte të organizonte një garë se kush do të lexonte më së shumti gjatë vitit shkollor. Paraparakisht, ata kishin biseduar me mësuesin e gjuhës shqipe, Shpëtimin. Atij i kishte pëlqyer ideja e nxënësve dhe u kishte premtuar se do t'i ndihmonte në gjetjen e librave të ndryshëm, sepse ai kishte një bibliotekë të pasur në banesën e tij.

Nxënësit krijuan edhe një faqe kompjuterike ku do t'i shënonin të gjithë titujt e librave që do të lexonin, si dhe do të mund të shtronin pyetje apo t'u përgjigjeshin pyetjeve për librat e lexuar. Faqen e titulluan «Lexuesit e rinj shqiptarë». Mësues Shpëtimi u tha nxënësve të tij se në fund të vitit shkollor do të jepte një shpërblim për lexuesin më të suksesshëm.

Diana dhe Besniku tashmë kishin lexuar mjaft libra në gjuhën shqipe, ngase ata kishin vijuar shkollën shqipe që nga klasa e parë. Ata bënë një listë të librave që dëshironin t'i lexonin.

Pas një jave, në faqen elektronike Genti kishte shënuar se kishte lexuar romanin „Verorja“ të Rexhep Hoxhës dhe kishte shtuar një koment: Roman shumë i bukur. Kush do ta lexojë?

Drita, nxënëse e klasës së shtatë, kishte filluar të lexonte romanin «Beni ecën vetë» të Kiço Blushit. Në koment kishte bërë një pyetje: Kam dëgjuar se ky libër është bërë edhe film. A e ka parë ndokush këtë film apo ka dikush nga ju një ide se ku mund ta gjej?


Pas një muaji, mësues Shpëtimi kishte organizuar një vizitë në bibliotekën ndërkulturore të qytetit. Ai ishte informuar se në këtë bibliotekë kishte një mori librash në gjuhën shqipe. Nxënësit mezi prisnin të shihnin se çfarë librash kishte aty. Kur u gjendën në hyrje të bibliotekës, përpara u doli bibliotekarja dhe i përshëndeti në gjuhën shqipe. Ata u habitën se si një bibliotekare flet në gjuhën shqipe. Por bibliotekarja, sikur ta priste këtë, buzëqeshi dhe u tha se ajo vinte nga Shqipëria. Nxënësit u kënaqën duke e dëgjuar se sa bukur fliste ajo. Suela, kështu quhej bibliotekarja, i çoi në katin e dytë ku gjendeshin disa rafta me libra në gjuhën shqipe. Ajo u sqaroi atyre se, për të pasur të drejtën e huazimit të librave, duhej që secili prej tyre të regjistrohej paraprakisht.

Të gjithë nxënësit u regjistruan njëri pas tjetrit dhe pastaj filluan t'i shfletonin librat me interesim. Në fund, secili kishte nga një libër në dorë. Shpendi kishte marrë romanin e Bedri Dedjes «Presidenti i planetit të kuq», kurse Drita kishte marrë romanin «Sikur t'isha djalë» të Haki Stërmillit. Elena kishte zgjedhur romanin «Gremina e dashurisë» të Mustafë Greblleshit, Visari mbante në dorë romanin e Zejnullah Rrahmanit «Romani për Kosovën», Drini kishte marrë një libër të shkrimtarit Odhise Grillo, kurse Shega mbante në duar romanin e Ismail Kadaresë «Kështjella». Kur bibliotekarja ia pa këtë roman,

i tregoi se është i përkthyer edhe në shumë gjuhë të ndryshme të botës. Shega, e cila në internet kishte lexuar plot informacione për shkrimtarin e famshëm shqiptar Ismail Kadare, menjëherë e pyeti atë se mos e kishin këtë roman edhe në gjermanisht. Suela shkoi dhe ia solli. Ajo u gëzua dhe mezi priste të fillonte leximin e romanit në shqip e gjermanisht.

Pas disa muajsh nxënësit e shkollës shqipe kishin lexuar shumë libra dhe gara se kush do ta zinte vendin e parë po bëhej gjithnjë e më e fortë. Ata kishin shkëmbyer përplot informacione. Për më tepër Iliri kishte gjetur një formë të veçantë për të lexuar një libër që nuk mund ta gjente. Kushëriri i tij në Kosovë ia dërgonte çdo javë nga 15 faqe përmes internetit, të cilat Iliri i lexonte me ëndje.

Në qershor, mësues Shpëtimi, pasi kishte kontrolluar me kujdes testet për librat e lexuar, ua kumtoi nxënësve të tij rezultatet. Pasi shikuan bashkërisht se edhe sa libra kishte lexuar secili prej tyre, panë se vendin e parë e zuri Diana. Ajo u gëzua shumë. Shokët e shoqet e uruan. Mësues Shpëtimi i kishte blerë pesë romane të cilët ia dhuroi Dianës. Ai u dhuroi edhe të gjithë nxënësve të tjerë nga një libër dhe i përgëzoi për pasionin e leximit. Në fund nxënësit u morën vesh që gjatë pushimeve verore secili prej tyre të sjellë së paku nga dy libra nga Atdheu. Kështu ata do të mund t'ia huazonin ato njëri-tjetrit në vitin tjetër shkollor.



Përgjigju pyetjeve!

1. Çfarë donte të organizonte grupi i të rinjve ?
2. Kush do t'i përkrahte ata ?
3. Përse hapën një faqe interneti?
4. Çfarë organizoi mësues Shpëtimi një ditë?
5. Cilin roman e huazoi Shega?
6. Çfarë forme përdorte Iliri për të lexuar një roman ?
7. Kush e zuri vendin e parë?
8. Çfarë u dhuroi mësuesi nxënësve?
9. Për çfarë u morën vesh ata?

Analizo!

1. Çka mendon, pse nxënësit kishin zgjedhur leximin për kohë të lirë?
2. Cilat janë dobitë që sjell leximi?
3. Ku mund të gjesh libra shqip dhe në gjuhë të ndryshme atje ku jeton? Informohu!
4. Krijoni (me ndihmën e mësuesit apo të mësueses) edhe ju një klub të lexuesve të rinj shqiptarë! Propozojë këtë ide shokëve dhe mësuesit/mësueses!

Detyrë:

1. Bëje një listë të librave që i ke lexuar në gjuhën shqipe! Mund të shënosh edhe ndonjë libër që ke lexuar në gjuhë të tjera.

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

Shkruaj shkurtimisht përmbajtjen e një libri që të ka pëlqyer shumë!

1. GJUHA SHQIPE - PASURI E PËRJETSHME

Ilirja ka disa ditë që e vëzhgon punën e infermiereve në spitalin e qytetit ku jeton. Ajo është ende nxënëse, por pas disa muajsh duhet të vendosë se çfarë profesioni do të zgjedhë. Kështu që, për të njohur më mirë disa profesione që i pëlqejnë, ka vendosur të vëzhgojë nga tri ditë në javë disa vende të ndryshme të punës. Pastaj ajo do ta ketë më të lehtë të vendosë se cilin profesion do ta mësojë.

Në spital ajo donte të merrte sa më shumë informacione për profesionin e infermieres. Ajo u ndihmonte infermiereve në kryerjen e punëve të ndryshme. Asaj i pëlqente kujdesi që tregonin ato për pacientët dhe gatishmëria për t'i dëgjuar kërkesat e tyre.

Një ditë ndodhi diçka e veçantë. Në spital ishte paraqitur një burrë i moshuar, i cili ndiente dhembje të mëdha në bark. Infermierja që e pranoi filloi t'i bënte disa pyetje, por burri i moshuar vetëm rrudhte krahët dhe nuk përgjigjej. Me shumë mund infermierja mësoi se ai quhej Shpend dhe se ishte nga Kosova. Ai kishte ardhur për vizitë te djali i tij dhe ishte sëmurë papritur.

Infermierja, duke ditur që Ilirja ishte me prejardhje nga Kosova, e thirri që t'i vinte në ndihmë për t'u kuptuar me Shpendin. Ajo shkoi menjëherë dhe filloi t'i përkthente pyetjet që i bënte infermierja dhe pastaj edhe përgjigjet që i jepte Shpendi. Kur infermierja i mori të gjitha të dhënat dhe mësoi se nga çfarë vuante Shpendi, e falënderoi Iliren dhe u bë gati ta dërgonte në kontroll te mjeku specialist.

Zoti Shpend iu drejtua Ilires:

- Faleminderit, moj vajzë, që më ndihmove të merresha vesh me infermieren. Po ku e ke mësuar shqipen aq mirë? - e pyeti ai.

- Unë kam shkuar tetë vjet në shkollën shqipe këtu në qytetin ku jetoj, - iu përgjigj Ilirja.

- Të lumtë, moj bijë! Sa mirë ke bërë që ke mësuar shqipen - i tha ai.

Infermierja e pyeti Iliren se çfarë po fliste me zoti Shpendin. Ajo i tregoi se për çfarë e kishte pyetur ai dhe i sqaroi infermieres se ajo kishte shkuar rregullisht edhe në shkollën shqipe të mësimin plotësues në qytetin ku jetonte.

Infermierja u mendua ca dhe i tha Ilires:

- Po të vendosësh të bëhesh infermiere ne do të të pranohim me dëshirë në spitalin tonë. Ne kemi nevojë për vajza si ti që dinë edhe gjuhën amtare, sepse kemi raste kur vijnë pacientë shqiptarë dhe kemi nevojë për ndihmë kur ndokush nga ta nuk e kupton mirë gjuhën tonë, - i tha ajo. - Ti mund edhe të studiosh më vonë dhe të punosh mjekë këtu.

Ilirja ishte krenare që mundi t'i ndihmonte zotit Shpend, bashkatdhetarit të saj. Ajo u gëzua që edhe infermierja e lavdëroi për



njohuritë e saj në gjuhën shqipe. Në mbrëmje ajo u tregoi prindërve se çfarë i kishte ndodhur. Ata ishin të lumtur që vendimi i tyre i para tetë vjetëve për ta dërguar vajzën në shkollën shqipe i kishte dhënë frytet e veta.

Përgjigju pyetjeve!

1. Përse ka shkuar Ilirja në spital ?
2. Përse i ndihmon asaj vëzhgimi që bën në spital?
3. Çfarë ndodhi një ditë?
4. Pse burri i moshuar nuk fliste?
5. Si e ndihmoi Ilirja zotin Shpend?
6. Çfarë e pyeti xha Shpendi Iliren ?
7. Si e kishte mësuar ajo gjuhën shqipe?
8. Çfarë oferte i bëri infermierja asaj ?
9. Çfarë u tregoi ajo prindërve dhe si u ndien ata?

Analizo!

1. A ke menduar se çfarë profesioni do të zgjedhësh?
2. Çfarë mendon ti, a ka bërë mirë Ilirja që ka vendosur të vëzhgojë disa vende pune përpara se të vendosë se çfarë profesioni do të zgjedhë për ta mësuar?
3. A ke bërë ndonjë plan se si do të vendosësh për zgjedhjen e një profesioni?

Detyrë

1. Shkruaj në dy shtylla profesionet më të popullarizuara dhe profesionet më të rralla!

--	--

2. Pyeti prindërit ose dikë tjetër se si janë përcaktuar për profesionin të cilin e ushtrojnë! Shëno informacionet që të japin dhe prezantoje para klasës!



3. PROFESIONET DHE PARAKUSHTET

Alma dhe Shpëtimi kishin bërë një ditë disa intervista me nxënësit e shkollës. Ata i kishin pyetur se çfarë ëndërronin të bëheshin në të ardhmen, si e kishin suksesin në shkollë, çfarë parakushtesh duhej të plotësonin për të zgjedhur profesionin e tyre të preferuar, cilat janë lidhjet që ata kanë me familjet, shokët, shoqërinë. Ja përgjigjet e tyre:

Tung! Unë jam Luani, jam 13-vjeçar. Banoj në Bern. Jetoj këtu me familjen time që shumë vjet. Unë jam i lindur këtu dhe kam tash dy shtetësi: kosovare dhe zvicerane. Unë dëshiroj të bëhem elektrikist. Jam një nxënës mesatarisht i mirë. Në matematikë jam shumë i mirë dhe shpresoj që kjo do të më ndihmojë të gjej një vend pune ku do të mësoj profesionin e elektrikistit. Prindërit e mi nuk janë edhe aq të kënaqur me këtë zgjedhje që kam bërë unë, por ata kanë parë që jam i vendosur dhe tash qëndrojnë prapa meje.

Unë jam Etleva, nga Maqedonia. Këtu jetoj tash 5 vjet. Unë deri në klasën IV kam jetuar në Strugë dhe pastaj kam ardhur këtu bashkë me familjen. Në fillim ishte shumë vështirë për mua, sepse nuk dija asnjë fjalë gjermanisht. Gjithçka ishte e re, shkolla, shoqëria. Më mungonte shumë shoqëria e vendlindjes. Por me kohë jam integruar këtu dhe tash mund të them që më pëlqen të jetoj këtu. Unë dua të bëhem shitëse në ndonjë shtëpi mallërash. Suksesi im nuk është edhe aq i mirë, për shkak të mosnjohjes së mirë të gjuhës. Por mësuesja ime më thotë që unë do të gjej një vend ku do të mësoj profesionin e shitëses. Prindërit e mi nuk janë gjithaq të kënaqur me suksesin tim, por ata e dinë se kjo është pasojë e asaj se unë kam ardhur vonë këtu.

Unë jam Dardani. Jam 12 vjeç. Shokët e mi më thonë se unë për pak gjë zemërohem dhe ndoshta këtë e kam trashëguar nga babai, i cili edhe për gjera të vogla zemërohet shpejt. Unë dua të bëhem financier që punon në bankë. Por, për ta arritur këtë, më duhet patjetër të shkoj në shkollën sekondare të tipit A. Mësuesi më thotë se unë mund të mësoj shumë, por jam pak përtac. Ndoshta ai ka të drejtë, sepse shpesh i bëj vetëm gjërat e domosdoshme. Por do të ndërroj mënyrën e të mësuarit që të realizoj ëndrrën time.

Unë jam Zana. Jam 14 vjeç dhe shkoj në klasën e shtatë. Kam nota shumë të mira dhe lexoj shumë. Pasionin për leximin duket se e kam trashëguar nga nëna, e cila lexon shumë dhe në Kosovë ka studiuar gjuhën shqipe. Prindërit e mi janë shumë të kënaqur me mua dhe më thonë se, nëse mësoj kështu, do të arrij që pas klasës VIII-të të jap provimin pranues për në gjimnaz. Dëshira ime e madhe është të bëhem mësuese dhe parakusht për këtë është të mësoj shumë dhe të kem nota të mira. Unë jam e bindur se do t'ia arrij që të regjistrohem në gjimnaz. Disa shoqe më kanë thënë se gjimnazi është i vështirë, por unë nuk i frikohem mësimit.

Tung! Unë jam Mentori. Jam 15 vjeç dhe shkoj në klasën e tetë. Pas disa muajsh do të kthehem në Kosovë bashkë me familjen time, sepse këtu nuk kemi mundur ta sigurojmë lejeqëndrimin. Unë kam pak frikë, sepse nuk e di si është tash atje. Për këtë shkak edhe nuk jam i interesuar të mësoj shumë, sepse e di se do të kthehem. Në njërin anë dua të shkoj në Kosovë, sepse atje kam kushërinjtë, dajat, tezet etj., por edhe këtu kam shumë shokë të mirë dhe për këta do të më marrë malli. Unë nuk e di se si do të vazhdojë shkolla atje, sepse babai më ka thënë se në Kosovë shkollimi është më ndryshe se këtu dhe unë duhet të përgatitem për shkollë të mesme dhe për të studiuar. Mua krejt këto më duken sikur ëndrra, por së pari po pres të shoh se kur do të kthehem definitivisht.

Alma dhe Shpëtimi, pasi i kishin shkruar edhe në kompjuter intervistat e nxënësve të ndryshëm të shkollës së tyre, i kishin lexuar ato para klasës. Pasi përfunduan së lexuari, mësuesi bëri një diskutim me ta për përmbajtjen e tyre. Nxënësve u pëlqyen mendimet e bashkëmoshatarëve të tyre.

Përgjigju pyetjeve!

1. Çka kishin bërë Alma dhe Shpëtimi?
2. Çka dëshironte të bëhej Arbri?
3. Pse Etleva nuk ka sukses aq të mirë?
4. Në cilin tip shkolle duhet të shkojë Dardani për t'u bërë financier?
5. Cili është pasioni i Zanës dhe çka dëshiron të bëhet ajo ?
6. Përse Mentori duhet të kthehet bashkë me familjen e tij në Kosovë ?

Analizoni në grup!

1. Diskutoni për përmbajtjen e intervistave që kanë dhënë nxënësit/nxënëset! Shënoni në fletore se cilat parakushte duhet t'i plotësojnë ata për të arritur qëllimet e tyre! Çfarë duhet të ndryshojnë ata? Çfarë mësoni ju nga këto intervista?
2. Bëni një tabelë me profesione të ndryshme dhe me parakushtet që duhen plotësuar për t'i mësuar ose studiuar ato profesione!



Thellim në temë

1. Bëje një intervistë me shokun/shoqen e klasës për profesionin që ai/ajo dëshiron të zgjedhë! Për ndihmë shiko intervistat në tekst!
2. Bëje një listë të parakushteve që duhet t'i arrish për të mësuar një profesion që ëndërron!



4. SHKOLLAT TONA JANË TË NDRYSHME

Besiana kishte dalë me kushëririn e saj në qytet. Ajo sa kishte ardhur për pushime në vendlindje. Drini, kushëririn e saj, është moshatar me të dhe jeton në Kosovë. Pasi shëtitën një kohë nëpër qytet, hynë në një ëmbëltore dhe porositën nga një lëng vishnje, se ishte vapë. Pasi të dy ishin në klasën e tetë dhe nuk ishin parë që një vit, filluan të bisedonin për jetën e tyre shkollore.

- Si shkon me mësimet këtë vit? - e pyeti Besiana Drinin.

- Jo edhe aq mirë, - tha Drini. - Kam dy nota jo të mira në matematikë dhe në fizikë. Këto lëndët natyrore nuk më pëlqejnë edhe aq shumë. Po ti ç'sukses ke në shkollë?

- Po mësoj shumë, sepse duhet të mbetem në këtë klasë që jam, - tha ajo.

- Si të mbetesh, nuk po kuptoj a do të ngelësh, a? - u habit Drini.

- Jo, jo, por po mendoj që duhet të mbetem në këtë klasë që është klasë e një niveli të lartë, - tha ajo.

- Pse, ka klasa të niveleve të ndryshme te ju? - pyeti plot kureshtje Drini.

- Po, janë tri nivele në ciklin e lartë: ai i ulët, i mesëm dhe i lartë, - sqaroi ajo. - Dhe unë jam në nivelin e lartë. Po të mos mësoj mirë, më vendosin në nivelin e mesëm dhe kjo nuk dua të ndodhë, sepse pastaj shansat e mia për të gjetur një vend të mirë mësimi janë më të vogla, - përfundoi ajo.

- Çka do të thotë kjo: vend mësimi? - pyeti ai duke qeshur pak, sepse iu duk e çuditshme që në klasën e tetë kushërira e tij të gjejë një vend mësimi.

- Eh, Drin, atje është shkolla pak më ndryshe se këtu, - tha ajo. - Ne duhet të kërkojmë një vend mësimi kur të fillojmë klasën e nëntë. Dhe pasi të gjejmë një vend mësimi, atëherë pas klasës së nëntë shkojmë edhe në shkollë edhe në punë. Kjo zgjat tri ose katër vjet, sipas profesionit. Pastaj e marrim një diplomë, që tregon se kemi mësuar një profesion të cilin do ta ushtrojmë në të ardhmen.

- Te ne është më ndryshe. Këtu as që mund të bëhet fjalë për një vend pune kaq herët. Unë kam për qëllim të shkoj në gjimnaz, - tha Drini, - dhe, pasi ta kryej gjimnazin, të studioj. Këtu është shumë vështirë të gjejmë një vend pune me shkollë të mesme. Po çfarë profesioni do të zgjedhësh ti? - e pyeti Drini Besianën.

- Unë kam dëshirë të punoj në fushën e financave, në ndonjë bankë ose ndërmarje. Por është mjaft vështirë të gjejmë një vend të tillë, sepse ka një konkurrencë të madhe, - tha ajo. - Për këtë arsye është me shumë rëndësi për mua që t'i kem notat e mira.

- Tash të kuptoj, - tha Drini i menduar. - Kurse unë duhet të mësoj që të kaloj së pari testin e maturës, që të mund të shkoj në shkollë të mesme.

- Kemi të dy shumë për të mësuar, - tha ajo. - Së paku, ti e ke më lehtë këtu, sepse shkon në shkollë ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe, kurse unë krejt mësimet duhet t'i bëj në një gjuhë që nuk është gjuha ime amtare.

- Po vërtet është ashtu, por për ty është shumë bukur që ti e mëson një gjuhë të huaj shumë mirë dhe mund të flasësh në atë gjuhë pa kurrfarë vështirësie, - tha Drini.

Duke biseduar për planet e tyre, Besiana e Drini kishin kaluar çaste të mira në ëmbëltoren e qytetit. Kur panë që ora kishte vajtur 12, u ngritën dhe, pasi Drini bëri pagesën, u nisën për në shtëpi, sepse i prisnin për drekë.



Përgjigju pyetjeve!

1. Për çka filluan të bisedonin Besiana dhe Drini?
2. Çka i tregoi Besiana Drinit?
3. Si ishte Drini me mësimet?
4. Çka duhej të bënte Besiana për ta gjetur një vend mësimi në fushën e financave ?
5. Po Drini çfarë qëllimi kishte?
6. Cila ishte përparësia e Drinit dhe cila e Besianës?

Analizo!

1. Bisedoni në grup dhe shënoni se cilat janë gjërat e përbashkëta të Besianës dhe të Drinit dhe cilat janë dallimet mes sistemit shkollor ku mëson Besiana dhe të sistemit shkollor ku mëson Drini.
2. Si është sistemi shkollor në vendin ku jeton ti? Bëj një skicë me tipat e ndryshëm që mund të ndiqen në ciklin e lartë dhe më vonë!

Detyrë

1. A ke të afërm në Atdhe që janë moshatarë me ty? Çka di ti për shkollimin e tyre ?
2. Shkruaji një letër ose një e-majl një të afërmi dhe tregoji për jetën tënde shkollore dhe pyete për gjërat që të interesojnë!

5. PROFESIONI I ËNDËRRUAR

Shpendi është nxënës i klasës së nëntë. Që në moshë të vogël atij i kanë pëlqyer shumë avionët. Kur shkonte me prindërit në dyqan për të blerë gjësende, sapo shihte në dollapët e lodrave ndonjë avion, u lutej babit e mamit me aq përdëllim sa ata nuk mund t'i rezistonin më lutjeve të tij dhe ia blinin. Kështu, Shpendi bëri një koleksion avionësh e helikopterësh në dhomën e tij dhe kënaqej duke luajtur. Për fatin e tij të mirë, jo larg qytetit, ku ai jetonte, ishte një aeroport i madh ndërkombëtar dhe ai shkonte shpesh atje me prindërit e tij dhe kënaqej duke i shikuar avionët e mëdhenj se si uleshin në pistën e aeroportit dhe ngriheshin përsëri.


Qysh në atë kohë atij i lindi dëshira të bëhej pilot. Në një ditë maji, kur ishte në klasën e tretë, ai u tha prindërve të tij se kur të rritej do të bëhej pilot. Ata e morën si një shaka fëmijërore të Shpendit, por ai këtë ëndërr të tij nuk e harroi asnjëherë. Duke e përmendur vazhdimisht dhe duke parë interesimin e tij të madh, edhe prindërit e tij filluan të mësoheshin me ëndrrën e tij. Bile babai i tij u interesua seriozisht për mundësitë që ekzistojnë, në mënyrë që Shpendi vërtet të bëhej pilot.

Kur ai i tha Shpendit se për t'u bërë pilot duhej të kishte sukses të shkëlqyeshëm në shkollë dhe më vonë duhej të jepte provimin pranues për t'u regjistruar në shkollën e aviacionit, Shpendi shumë i lumtur i premtoi babait se do t'i përkushtohej mësimin dhe do të arrinte sukses të shkëlqyeshëm.

Kështu Shpendi u angazhua shumë në mësim dhe kur diçka nuk dinte, atë e ndihmonte motra e madhe Shëga ose prindërit. Gjatë klasës së shtatë, të tetë dhe tash në klasën e nëntë, përpos mësimëve, ai lexon shpesh në internet informacione që kanë të bëjnë me aviacionin. Nëna e tij i ka blerë disa libra për këtë profesion. Edhe një muaj ai ka provimin pranues. Shokët e tij që tash e thërrasin me shaka pilot. Shpendi nuk u hidhërohet atyre, sepse e di që nuk e kanë me të keq. Ai është i gëzuar që ka disa shokë të mirë, të cilët gjithashtu mësojnë shumë.

Për provimin pranues ai ka marrë nga shkolla e aviacionit testet e disa viteve të mëparshme dhe i ka studiuar ato me kujdes. Shpendi është i bindur se provimin do ta kalojë me sukses dhe profesioni i tij i ëndërruar aq gjatë do të bëhet një ditë realitet dhe kështu do të mund të fluturojë në vende të ndryshme të botës, e kushedi edhe në Kosovë, Shqipëri etj. Duke ëndërruar udhëtimet nëpër botë, Shpendi pret me padurim ditën kur do të hyjë në provimin pranues.

Çka mendoni ju? Do t'ia dalë Shpendi?



Përgjigju pyetjeve!

1. Cilat lodra kishte dëshirë t'i blinte Shpendi i vogël në dyqan?
2. Çfarë kishte afër qytetit ku banonte ai?
3. Çfarë dëshire i lindi Shpendit dhe kur?
4. Kush e përkrahu Shpendin?
5. Cilat kushte duhej t'i plotësonte Shpendi për t'u regjistruar në shkollën e aviacionit?
6. Çfarë bënte ai për t'u përgatitur sa më mirë për provimin pranues?
7. Çka mendon ti, a do t'ia dalë Shpendi që ta jepë me sukses provimin pranues?



Analizo!

1. Sa të duket e realizueshme ëndrra e Shpendit?
2. Pse mund të realizohen disa gjëra që i ëndërrojmë, kurse disa të tjera jo ?
3. Si ndihesh ti kur nuk mund të realizosh një dëshirë ?

Detyrë

Pasi ta kesh lexuar tekstin edhe një herë, shkruaj një përfundim të mundshëm sipas mendimit tënd! Siç i shkuan Shpendit punët, çka është bërë pastaj?

6. MOSMARRËVESHJE ME BABANË

Kushtrimi sapo është kthyer nga shkolla dhe do të hajë pak bukë dhe do të pushojë para se t'i bëjë detyrat. Nganjëherë është aq i lodhur sa përton t'i bëjë detyrat menjëherë dhe del të luajë. Kur kthehet, shikon televizorin dhe harron që nuk i ka bërë detyrat. Të nesërmen mësuesi ia shkruan vërejtjen në fletoren e detyrave dhe pastaj babai ose nëna e tij duhet të nënshkruajnë. Edhe sot ai ka marrë një vërejtje të tillë. Në mbrëmje duhet t'ia japë babait për nënshkrim. Pret qortime. Babai i Kushtrimit, Bujari, dëshiron që djali i tij të shkojë në studime dhe të bëhet arkitekt. Bujari punon në ndërtimtari dhe lodhet shumë nga punët e rënda të ditës. Me fëmijët më shumë merret gruaja e tij, Hana. Ajo mundohet t'i ndihmojë ata dhe i kontrollon se a i kanë bërë detyrat e shtëpisë.

Kur Kushtrimi ia dha babait fletoren për ta nënshkruar, u krijua një situatë e rëndë.

-Kjo është hera e fundit që unë duhet të jap një nënshkrim për gjëra të tilla. Ti nuk bën më të mos i bësh detyrat, a more vesh! – i bërtiti i ati.

Kushtrimi i mërzhitur i premtoi babait se nuk do të lejonte më të ndodhte kështu.

-Më fal, babi, por nganjëherë po harroj t'i bëjë detyrat, siç harron edhe ndonjë shok tjetër.

Babai i tij, në vend që të qetësohej, u zemërua edhe më shumë.

-Ti mos i shiko të tjerët! Mëso për vete, sepse duhet të studiosh, që të bëhesh arkitekt.

Kushtrimi u zu ngushtë. Ai e dinte dëshirën e babait, por nuk donte të studionte.

-Baba, dua të bëhem automekanik! – iu përgjigj.

-Si? – iu hakërrye babai, - Automekanik bëhesh kur të duash. Ti duhet të mësosh në shkollë që të bëhesh arkitekt!

-Baba, unë nuk mund të bëhem arkitekt, sepse nuk jam shumë mirë me mësimet, - tha ai.

-Çka do të thotë kjo që nuk je mirë me mësimet? Ti duhet të përfundosh shkollën fillore dhe shkon në gjimnaz e mbasandej studion, - tha babai ende i zemëruar.

-Por nuk mund të shkoj në gjimnaz, sepse duhet t'i kem notat shumë të mira për gjimnaz. Unë dua të bëhem automekanik. Dua të gjej një vend pune e mësimi dhe kështu edhe do të punoj e do të mësoj, bile edhe më paguajnë pak për punën që bëj.

-Unë nuk dua që ti të bëhesh mekanik. Unë dua që ti të shkosh në shkollë dhe të studiosh, - thirri i vendosur babai i Kushtrimit.

-Baba, edhe unë do të doja të studioja, por nuk është e mundur, sepse nuk më lejojnë. Por ti e di që je i ftuar në mbledhje të prindërve, javën e ardhshme. Aty mësuesi do të sqarojë se cilat janë mundësitë e mia, - u shpreh Kushtrimi i pikëlluar që do ta zhgënjente babanë e tij.


Java tjetër erdhi shpejt. Në mbrëmjen e së mërkurës Kushtrimi bashkë me babanë e tij shkuan në mbledhjen e prindërve. Interesimi i prindërve ishte më i madh se zakonisht. Kishin ardhur bashkë me fëmijët e tyre. Ata e dëgjuan me vëmendje mësuesin, i cili u shpjegoi atyre se fëmijët e tyre këtë vit do të vendosnin se çfarë profesioni do të zgjidhnin dhe pastaj do të fillonin të konkurronin në vende të ndryshme për të gjetur një vend

mësimi. Ai u sqaroi atyre se kishte mbi treqind profesione te ndryshme, të cilat mund t'i zgjidhnin nxënësit.

Në pjesën e dytë ishte radha që prindërit të shtrojnë pyetje. Babai i Kushtrimit, pasi ngurroi një copë herë, mori guximin ta pyeste mësuesin se pse djali i tij nuk mund të shkonte në gjimnaz. Mësuesi i tha se për të shkuar në gjimnaz duhej pasur notat shumë të mira dhe duhej dhënë provimin pranues. Kushtrimi, me suksesin që ka, nuk i plotëson kushtet të shkojë në gjimnaz.

Duke parë se Bujari ishte i pakënaqur me atë çka tha, mësuesi shtoi se mundësia e të rinjve për të studiuar nuk përfundon nëse ata zgjedhin tash një vend pune për të mësuar një profesion. Ata kanë mundësi që të përfundojnë maturën dhe pastaj mund të studiojnë.

- E sheh, baba, që kam mundësi edhe unë më vonë të studioj nëse dua, - i tha Kushtrimi i lehtësuar.



Përgjigju pyetjeve!

1. Pse i harron Kushtrimi detyrat e tij herë pas here?
2. Si u arsyetua Kushtrimi para babait për mosbërjen e detyrave?
3. Cila ishte dëshira e Bujarit për djalin e tij?
4. Çfarë dëshironte të bëhej Kushtrimi?
5. Pse nuk mund të shkonte ai në gjimnaz?
6. Çfarë pyetje i bëri Bujari mësuesit dhe si u përgjigj ai?
7. Pse u lehtësua babai i Kushtrimit?
8. Çfarë i tha Kushtrimi babait në udhëtim e sipër?

Analizo!

1. Çka mendon ti: a) A kishte të drejtë babai i Kushtrimit që nuk pajtohej me vendimin e djalit të tij? b) Pse nuk pajtohej me këtë vendim?
2. Po prindërit e tu çfarë presin nga ti? A bisedon me ta shpesh për planet e tua për shkollim?
3. A ke edhe në familjen tënde konflikte në lidhje me zgjedhjen e profesioneve të fëmijëve? Cili është shkaku i konflikteve, si i zgjidhni ato?

Detyrë

1. Çka duhet të kesh parasysh kur përcaktohesh për një profesion?
2. Me kë bisedon kur ke vështirësi në shkollë apo ndonjë problem në jetën e përditshme?

7. PROFESIONET NË ATDHE DHE NË VENDET E TJERA

Për pushimet e pranverës një grup nxënësish nga Zvicra vizitoi Kosovën. Ata panë vende të ndryshme dhe një ditë shkuan edhe në një shkollë fillore, ku i takuan bashkëmoshatarët e tyre. Gjatë bisedës ra fjala edhe për profesionet që ëndërrojnë të rinjtë e Kosovës dhe ata të Zvicrës.



- Unë do të bëhem filigranist, - tha Petriti nga Prizreni. - Është një profesion që merret me përpunimin e stolive të ndryshme të arit dhe të argjendit.

- Unë do të bëhem dizenjatore e modës, - tha Flutura. - Më pëlqejnë shumë veshjet e ndryshme.

- Unë dëshiroj të bëhem gazetare që të udhëtoj në vende të ndryshme të botës, - qeshi Brisilda, e cila para disa vitesh ishte kthyer nga Zvicra për të jetuar në Prishtinë.

- Unë mendoj që të bëhem inxhinier i rrugëve, - tha Genti.

- Unë do të shkoj në Zvicër të studioj për muzikë, - tha Drita duke qeshur. Kam dëgjuar se atje ka shkolla të mira për muzikë.

- Nëse është puna për muzikë, atëherë jam unë i pari që duhet të dalë jashtë për të studiuar. - tha Mentori.

Genta, u ngrit në këmbë dhe iu drejtua të gjithëve:

- Për të parë se shoqja ime Drita vërtet e meriton të studiojë muzikën, ajo do të na këndojë një këngë.

Ajo filloi të këndonte këtë këngë të Sabri Fejzullahut:

*Merrma shiun e Prishtinës,
Pika- pika mbushe n'gotë.
Ma dërgo me lotin tënd,
Ta pi larg, diku në botë.*

Oooo oooo ooooo!



Të rinjve u pëlqeu shumë kjo këngë. Gjini, një nxënës nga Zvicra, i ngazëllyer nga këndimi i bukur i Dritës, iu kthye Mentorit:

- Mentor, Drita qenka supertalente.

Atë pasdite të rinjtë nga Zvicra bashkë me bashkëmoshatarët e tyre nga Prishtina kaluan çaste të këndshme. Ata u miqësuan aq shpejt, sa grupi i të rinjve nga Prishtina vendosi ta ftonte grupin e të rinjve nga Zvicra në një mbrëmje argëtuese. Ata u ndanë për t'u takuar në mbrëmje të përmendorja e Skënderbeut, në qendër të Prishtinës.

Përgjigju pyetjeve!

1. Çka do të bëhej Petriti dhe pse? Cila do të jetë puna e tij?
2. Po Flutura pse dëshironte të bëhej dizenjatore?
3. Pse është profesioni i gazetares atraktive për Brisildën ?
4. Cila ishte dëshira e Gentit?
5. Cilën këngë e këndoi Drita dhe cili këngëtar i njohur e ka kënduar?
6. Çka tha Gjini pasi Drita e përfundoi këngën?
7. Çka vendosi grupi i të rinjve të Prishtinës?

Analizo!

1. Çka mendon ti, cilat janë mundësitë e të rinjve në Atdhe dhe në mërgim për zgjedhjen e një profesioni?
2. Bëni një listë të profesioneve që kanë zgjedhur të rinjtë nga Prishtina dhe të rinjtë nga mërgimi dhe mundohuni të arsyetoni se pse dëshirojnë t'i mësojnë ato profesione!

Detyrë

- Çka mendon për dëshirën e Gentit? A do të doje të punoje kur të kesh përfunduar shkollimin në Kosovë po të jepej mundësia?
Arsyeto pse po, ose jo!



PUNA DHE KOHA E LIRË NË ATDHE

8. JETA DHE PUNA NË FSHAT DHE NË QYTET

- A ka si jeta në qytet?! - thonë shumë të rinj.
- A ka si jeta në fshat?! - thonë mjaft të moshuar.

Shpeshherë mendohet se jeta në qytet, për shkak të dinamikës së vet, është më e mirë, më tërheqëse dhe më e bukur se në qytet. Por, sapo të kalojë mosha e ëndrrave të mëdha të rinisë, e dëshirave për mbrëmje të zhurmshme, bukuria e jetës në fshat, me qetësinë dhe veçantinë e vet, kthehet në kërkesë të fuqishme.



Ata që jetojnë në qytet kanë një jetë më të rehatshme, edhe pse kanë hapësirë më pak. Qyteti ofron mundësi më të mëdha punësimi. Po ashtu besohet se shkollat e qytetit janë më të avancuara. Në qytet ka spitale, banka, zyra civile, kinema, teatro, hotele, klube etj.

Mirëpo edhe jeta në qytet i ka disa mangësi. Kostoja e jetesës aty është mjaft e lartë krahasuar me fshatin. Të mos flasim për mungesën e ajrit të pastër dhe të ujit të pijshëm, për ndotjen e mjedisit me pluhur, gazra, mbeturina. Shkalla e krimeve është më e lartë. Vrasës e hajna gjejnë strehë në qytet. Aty ka gjithnjë tollovi dhe zhurmë, shumë makina e njëjërëz në rrugë. Kjo e bën jetën në qytet mjaft të pashëndetshme dhe me stres.

Jeta në fshat i ka përparësitë e veta. Aty njerëzit jetojnë në qetësi dhe në afri me njëri-tjetrin. Edhe pse paraja aty fitohet vështirë, megjithatë ajo është e mjaftueshme për jetën që bëjnë banorët e fshatit. Banorët e fshatit gjithnjë janë mbrojtës të vlerave dhe të kulturës tradicionale. Fshati ofron ajër të pastër dhe mjedis të bukur e hapësirë të mjaftueshme për jetë. Ka më pak zhurmë, më pak tollovi e ndotje. Nuk ka shumë makina. Rrugët janë më pak të rrezikshme. Aty mund të kultivohen pemë dhe perime të freskëta, mund të mbahen kafshë dhe të zihet djathë e të gjitha prodhimet e qumështit. Por edhe fshati ka edhe të meta. Jo gjithnjë dhe të gjithë banorët e fshatit kanë shkollim të mirë. Nxënësit e fshatit ndjekin shkollat e atyshme që shpesh nuk janë të nivelit të shkollave në qytet. Tërë banorët e fshatit duhet të udhëtojnë shpesh në qytet për qëllime shkollimi, pune



e tregtie. Fshatarët kanë shpesh edhe probleme më të mëdha me infrastrukturë, si me ujë, kanalizim etj. Koha e lirë kalohet më vështirë, sepse nuk ka vende të veçanta argëtimi për të rinjtë. Në diasporë lidhja e fshatit me qytetin është më e madhe dhe ka më pak dallime qytet-fshat. Ndërkohë edhe në trojet shqiptare këto dallime po vijnë duke u zvogëluar. Prandaj gjithnjë mbetet një pyetje pa përgjigje përfundimtare: më mirë në fshat apo në qytet? Pa dyshim që përgjigjja gjendet në preferencat tuaja.



Përgjigju pyetjeve!

1. Cilat janë karakteristikat e jetës në fshat?
2. Cilat janë karakteristikat e jetës në qytet?
3. Çka të pëlqen ty personalisht nga jeta e fshatit dhe çka nga jeta e qytetit?

Detyra

1. Bëni në grupe nga një pllakat (poster) ku bëni ‘propagandë’ për jetën në fshat dhe në qytet!
2. Shpjego si jeton në fshat një familje që e njeh, duke theksuar përparësitë dhe mangësitë e fshatit!
3. Shpjego si jeton në qytet një familje që e njeh, duke theksuar përparësitë dhe mangësitë!
4. Anketo të njohurit e tu dhe shokët e klasës lidhur me preferencat e tyre për fshatin apo qytetin!
5. Debato në klasë në temën:
 - Pse në fshat?
 - Pse në qytet?

Përshkruaj!

1. A janë prindërit tuaj nga fshati apo nga qyteti? Përshkruaj lidhjet e tyre me fshatin apo me qytetin!
2. Përshkruaj dhe krahaso ngjashmëritë dhe dallimet e jetës në fshat apo qytet në vendin ku jetoni me ato në vendlindje!

9. PUNA NË NDËRMARRJET PUBLIKE DHE PRIVATE

Në Kosovë dhe në Shqipëri shumica e ndërmarrjeve publike e shtetërore janë privatizuar ose vazhdojnë të privatizohen.

Në Kosovë, PTK-ja (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës), minierat e Trepçës dhe KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës) vazhdojnë të jenë ndërmarrjet publike më të mëdha, një pjesë e të cilave do të privatizohen. Po kështu ka ndodhur dhe ndodh edhe me ndërmarrjet publike në Shqipëri. Te ndërmarrjet e mëdha si është PTK-ja, zakonisht një pjesë të aksioneve e ruan shteti dhe pjesa tjetër privatizohet.

Si ndërmarrje publike e suksesshme në Kosovën e pasluftës së vitit 1999 radhitet *Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës*, e cila ishte themeluar që më shumë se gjysmë shekulli (1959) dhe ishte quajtur *Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës*.

Në fillim të viteve '90 punëtorët shqiptarë dhe të tjerë që nuk ishin pajtuar me politikën e Milosheviqit, ishin dëbuar nga puna. Lufta i kishte sjellë kësaj ndërmarrjeje dëme të mëdha. Pas luftës, me ndihmën e ndërkombëtarëve, kjo ndërmarrje u rifunksionalizua sërish dhe gradualisht u bë ndër ndërmarrjet më të suksesshme publike, duke sjellë shumë të hyra edhe për buxhetin e Kosovës.

Për disa vite PTK-ja krijoi tri njësi biznesi: Postën e Kosovës, operatorin mobil *Vala* dhe Telekomini e Kosovës. PTK-ja ia doli që të kishte një plan biznesi pesëvjeçar me një investim prej 550 milionë eurosh. Po ashtu, një shtrirje të madhe, pothuajse në 90% të territorit të Kosovës, e ka edhe operatori mobil *Vala*, i cili ofron shërbime të ndryshme komunikimi. Ndërkohë PTK-ja ka bërë kontratë me *Hekurudhat e Kosovës*, që të instalojë kabllon optike përgjatë hekurudhave. Nga PTK-ja është shtruar kërkesa në zyrat e ITU-s (Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikacion) për miratimin e kodit telefonik ndërkombëtar për Kosovën, çka ende vazhdon ta pengojë PTK-në që të jetë në konkurrencë me ndërmarrjet e tjera rajonale si ajo.

Me rreth 2.480 punëtorë, PTK-ja ka ngritur Qendrën për Trajnim dhe Zhvillim, e cila ndihmon avancimin e punëtorëve të PTK-së. Ndërkohë është zhvilluar edhe procesi i korporatizimit të PTK-së dhe kalimi i saj në shoqëri aksionare të njohur dhe të pranuar ndërkombëtarisht.

PTK-ja ka deklaruar misionin e saj në këtë mënyrë:

“Të jetë gjithmonë prijëse në ofrimin e shërbimeve superiore të komunikimit, që ua përmirësojnë jetën të gjithë qytetarëve, përmes pasionit të njerëzve tanë dhe përmes përdorimit të teknologjisë më bashkëkohore të sprovuar.”

Kështu PTK-ja vazhdon të mbetet një tregim i suksesshëm i ndërmarrjeve publike në Kosovë.

Ndërsa, nga ndërmarrjet publike të privatizuara, *Ferronikeli* i Drenasit mund të përmendet si një gjigant metalurgjik, i cili ka vazhduar të ketë sukses edhe pas privatizimit.



Kompleksi i Ferronikelit shquhet për niklin dhe depozita të tjera minerale. Lufta e vitit 1999 e kishte dëmtuar shumë dhe e kishte paaftësuar këtë kompleks, por, pas privatizimit të tij më 2006, *Ferronikeli* është ngritur sërish në këmbë dhe tash e vazhdon suksesin e tij si ndërmarrje private.



Kuptoni dhe shpjegoni!

1. Kur ka filluar procesi i privatizimit në Kosovë?
2. Numëro disa nga ndërmarrjet më të sukseshme publike në Kosovë!
3. Cilat janë ndërmarrjet e sukseshme private që njeh?
4. Çka është *Ferronikeli*?

Detyrë

1. Debatoni në klasë lidhur me pronën private dhe shtetërore e publike!
2. Shkruani një ese mbi procesin e privatizimit në Kosovë!
3. Shpalo para shokëve dijet që ke për mineralet e Kosovës!

Shkruaj çfarë di në temën:

1. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës: e kaluara dhe e sotmja.
2. Për cilat ndërmarrjet private ke dëgjuar ti e që janë nga më të njohurat në të gjitha trojet shqiptare (Kërkoni edhe ndihmën e mësuesit).

10. KOHA PËR LOJË

Kanë thuar se të njëjtën moshë.

Ndjekin mësimet në të njëjtën shkollë.

Altini banon në Ulpianë, Agroni në Dardani. Ata takohen për lojë pothuajse çdo ditë pasdite, por veçanërisht të shtunën e të dielën bëjnë lojëra të organizuara me më shumë vetë.

- Nesër është e shtunë. A do të shkojmë të luajmë basketboll në Gërmi? - pyet Agroni.
- Pse, nuk do të luajmë futboll? - sikur habitet Altini.
- Po shoqet tona të klasës nuk po duan të luajnë futboll. Rina, Elsa dhe Zamira më kanë lutur që t'u tregojmë nëse shkojmë të luajmë basketboll në Gërmi.
- Do të vijmë edhe Genti dhe Loni?
- Po, po! Ata janë gjithmonë të rregullt.
- Po me çka do të shkojmë?
- Me autobus! Me çka tjetër! Më së lehti dhe më së liri.
- Atëherë, i thërrasim të gjithë dhe takohemi nesër në orën 11.00, këtu në stacion.
- U tha, u bë!

Kështu, gati për çdo fundjavë, Altini dhe Agroni me shokë e shoqe takohen dhe dalin e lozin së bashku. Blejnë edhe pije freskuese që ta shuajnë etjen.

Po prindërit e tyre? As ata nuk mbeten keq. Shpesh, pas orarit të punës, në mbrëmje takohen dhe dalin e luajnë futboll, shëtisin së bashku, dëfrehen.

Ndonjë, si e ëma e Elsës, ankohet gjithnjë se pas lodhjes nga puna po përton të dalë të shëtisë a të luajë në mbrëmje, por miqtë e saj nuk e pyesin fort dhe e marrin me vete. Dhe, si përfundim, ajo gjithnjë del më e kënaqura nga loja e shëtitja.

Sikur të gjithë pajtohen se nuk ka kuptim shkolla dhe puna pa lojë, pa pasditet dhe fundjavët e këndshme. Ato janë si një ëmbëlsirë që e shoqëron jetën e bukur.



Pyetje

1. Çfarë sporti adhurojnë Altini dhe Agroni dhe çfarë loje vendosin të luajnë në Gërmi?
2. Po Elsa, si ia kalon me miqtë e saj?
3. Sa është e rëndësishme loja për njerëzit dhe pse?

Trego!

1. Kush i organizon lojërat në rrethin tënd?
2. Sa ka hapësira loje në shkollën tënde?
3. Sa ka hapësira loje në mjedisin ku ke shtëpinë?
4. Çka do të ishte ëndrra jote në lidhje me hapësira loje atje ku banon ti?

Organizo!

1. Bashkë me shoqet e shokët gjatë një pasditeje organizoni lojën që ju pëlqen!
2. Merr iniciativë në shkollën e komunën tënde për krijimin e hapësirave të reja të lojës! Konsultohu me shokët/shoqet se çka mund të bëni!
- 3.



11. FOLKLORI SHQIPTAR

Folklori shqiptar shquhet për pasurinë e traditave të përcjella me shekuj.

Ky folklor nënkupton përrallat, këngët kreshnike, këngët polifonike, anekdotat, format e ndryshme epike dhe lirike, ritet dhe zakonet e ndryshme të përcjella brez pas brezi.

Vetë zanafilla e folklorit lidhet me elemente të traditave zakonore, muzikore e rituale, me valle e lojëra të ndryshme, prandaj mund të thuhet se është shumë i vjetër, pothuajse një bashkëshoqërues i njeriut që nga fillet e tij. Bota shpirtërore, mendore dhe fizike e njeriut shprehet shpesh përmes folklorit.

Edhe folklori shqiptar ka shenja të qarta të lashtësisë që mund të gjenden te përrallat, këngët kreshnike, legjendat, baladat, mitet, ritet e ndryshme etj. Vetëm te përrallat dhe këngët e ciklit të kreshnikëve, p.sh. mund të hasim figura të shumta mitologjike, si zana, dragoi, kulçedra, katallani, bajlozi, djali gjarpër, orët, shtojzovallet, etj.

Folklori shqiptar ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e traditave kombëtare dhe të jetës së pasur materiale e shpirtërore.

Të shohim një fragment nga këngët kreshnike, përkatësisht nga “Martesa e Halilit”.

*Dheu m'ka mblue e fat s'i qita vedit
po s'e mora Tanushën e Krajlit
E unë Tanushen vetë e kam pa
Gja ma t'mirë s'sheh njeri nën këtë diell
Vetulla e saj e drejtë si fiskaja
Shtegu i ballit si shtegu i malit
Kur merr hana me prendue
Syni i saj si kokrra e qershisë
E ka qerpikun si krahu i dallendeyshes*

*Fytyra e saj si kuqet molla n'degë
Hunda e drejt-o si kalemi i Tushës
Goja e vogël si lulja që shpërthen
Dhambët e bardhë si gurëzit e lumit
Fill mbas shiut, kur po i shndrit dielli
Qafa e saj si qafa e pëllumbit
Shtati i saj porsi shtat çetine
Mishi i dorës posi rrem shemshirit.*

Këtu, personazhi i kangëve kreshnike, Halili, me fjalët më të zgjedhura, flet për bukurinë e Tanushës, së cilës ia ka vënë syrin.



Pyetje dhe detyra

1. Çka kupton me folklor?
2. Për çka shquhet folklori shqiptar?
3. Gjej figurat me të cilat Halili e përshkruan bukurinë e Tanushës!

Punë në grup

1. Bashkë me shokë e shoqe demonstroi se si luhet një valle shqiptare!
2. Tregoni secili nga një anekdotë shqipe.
3. Mblidhni nga anëtarët e moshuar të familjes një përrallë shqipe. Shkruajeni dhe tregojeni në klasë!

Detyra shtesë

1. Inçizojë në familjen e gjerë një këngë popullore shqipe dhe komentoje në klasë!



Abdurrahim Buza,
Lojërat tradicionale

12. LOJËRA TË ATDHEUT

Dikur në disa pjesë të Kosovës luhej loja popullore *filxhanas* (gjetja e kokrrës nën filxhan). Ata që e fitonin lojën i këndonin me tallje humbësit. Tashmë ajo lojë ka mbetur vetëm në tregimet e të moshuarve. Të rinjtë e sotëm luajnë ndryshe.



Loni dhe Laura janë vëlla e motër, por jo rrallë u ndodh të grinden.

- Lon, pse nuk vjen me mua dhe me shoqet e mia të luajmë volejball? - e akuzon Laura.

- Sepse unë nuk e dua volejballin!

- Atëherë as unë nuk e dua futbollin. Te ne vetëm djemtë luajnë futboll...

- E kush ua ndalon, Laura?

- Nuk na e ndalon askush, po ja që kështu ndodh...

- Bëj si të duash!

- Ti je egoist! - fillon dhe e humb durimin Laura dhe ikën me vrap te prindërit dhe shpesh ia shkreh të qarit.

Skena të tilla nuk janë të përditshme, por megjithatë ndodhin. Së fundit, pasi Loni shkoi me shokët e vet të luajë futboll, Laura bëhet bashkë me shoqet e saj dhe së bashku shpikin ndonjë lojë, por gjithnjë i mbetet dëshirë e porealizueshme pse s'mund të luajë bashkë me vëllanë e saj. Disi nuk i pëlqen lojërat e ndara për djem dhe për vajza. Nuk i sheh dot gjinitë e ndara në futboll, atletikë, not, volejball, hendboll... Aq më tepër kur shumë nga këto lojëra vajzave sikur nuk u preferoheshin dhe ato ndjiheshin keq.

Një ditë ajo ia shfaqti arsimtarit të edukatës fizike një ide:

- Arsimtar, pse nuk organizojmë lojëra në ping-pong, djem e vajza, pas mësimit, në sallën e kulturës fizike?

Arsimtari u mendua dhe tha:

- Punë që bëhet!

Dhe vërtet nga ajo ditë Loni dhe Laura filluan të luanin edhe së bashku, pa i harruar lojërat e tjera të mëhershme. Dhe e kuptuan se sa bukuri kishte loja kur luanin djem e vajza bashkë. Ndonëse djemtë ishin gjithnjë më ngucakëqinj, gjithnjë kalonin bukur së bashku dhe dëfreheshin për mrekulli.



Shpjego!

1. Pse grinden Laura dhe Loni?
2. Çfarë ideje i shfaq Laura arsimtarit të edukatës fizike?
3. A ju pëlqejnë më shumë lojërat e organizuara në shkollë apo në shtëpi?

Shkruaj!

1. Përshtuaj lojën që të pëlqen më së shumti dhe rregullat e saj!
2. Sa është e rëndësishme loja së bashku?
3. A mund t'ua zëvendësojë plotësisht kompjuteri lojën?
4. Shkruaj një shkrim për lojtarin tënd të adhuruar!
5. Zhvillo një intervistë të imagjinuar me lojtarin që të pëlqen më shumë!

Organizo!

1. Organizo me shokët ndonjëherë nga lojërat më të popullarizuara në vendlindjen tënde!
2. Pyet të moshuarit se si organizohej loja *filxhanas* dhe organizo në klasë një lojë të tillë tradicionale!



13. DALJA NË MBRËMJE



- Ku po shkojmë sonte?
- Te kompleksi *Qafa*?
- Jo! Më mirë te *Kurrizi*.
- Jo, jo... aty jo!
- Po ku?
- Diku tjetër.
- Në *Gërmi*?
- Ani.



Këto janë bisedat e përditshme të vajzave dhe të djemve në mbrëmje. Njësoj ndodh në Prishtinë, Tetovë e në Shkup, në Tiranë e në Ulqin! Të rinjtë debatojnë për vendin e tyre të preferuar ku do të qëndrojnë gjatë mbrëmjes. Natyrisht, vetëm një pjesë e tyre dhe vetëm gjatë ndonjë dite të javës vizitojnë lokale e kafiteri.

Por, natyrisht, se këta të rinj e kanë me dije se alkooli ndalohet për moshën e tyre. Së fundit në Atdhe është miratuar ligji që ndalon shitjen e pijeve alkoolike atyre që nuk e kanë moshën e duhur. Prandaj ata kënaqen me ndonjë lëng apo pije freskuese që ua do qejfi.

Arta dhe Artani kanë shëtitur nëpër gjithë këto qendra gjatë verës dhe janë kënaqur. Tirana nuk është më ajo e para njëzet viteve. Edhe Tetova është ringjallur. Janë kënaqur edhe në Strugë, afër liqenit, në shëtitore.

Në Prishtinë jeta e mbrëmjes sa vjen e bëhet më dinamike, me diskot e programet që jepen në qendra të ndryshme. Prindërit e Artanit dikur shëtisnin nëpër *korzo*. Tashmë *korzoja* duket më e qetë dhe sikur andej rrinë më shumë të moshuarit dhe kalimtarët e rastit.

Një pjesë e të rinjve të Prishtinës dalin në periferi të qytetit, posaçërisht në restorantet e Gërmisë, ku fladi i verës apo panorama me borë nën dritat e neonit u ofron atyre përjetime të këndshme. Aty shpesh ndodhin takimet e para, simpatitë e para.

Mendo!

1. Cilat vende i preferon në Atdhe për ta kaluar mbrëmjen?
2. Si janë mbrëmjet aty ku jeton krahasuar me atdheun tënd?
3. A parapëlqen për mbrëmje shëtitje, dëfrimet me shokë në lokale të mbyllura, te njëri-tjetri, apo diçka tjetër?
4. Cilat janë të mirat dhe të këqijat e daljes në mbrëmje?

Të mirat

Të këqijat

Diskutoni në grup!

1. Ku do të dilnit më së pari në mbrëmje, po të ishit në Kosovë?
2. Çka do të zgjidhnit ndërmjet një koncertit me muzikë klasike, popullore apo daljes me shokë në një mjedis të preferuar dhe pse? Arsyetoni!

Organizoni!

1. Organizoni një dalje në mbrëmje në vendin tuaj të preferuar!
2. Gjatë fundjavës, bashkë me shokët/qet organizoni një dalje në natyrë dhe përgatiteni ushqimin vetë!





Dëgjoni dhe këndoni për lumturinë!

Kjo këngë është një himn kënduar lumturisë, kompozuar nga Avni Mula me tekst të poetit të njohur Luigj Gurakuqi e në interpretim të këngëtares së njohur shqiptare Vaçe Zela! <http://www.youtube.com/watch?v=Egg-b9A1MxU&feature=related>



Valsi i lumturisë

Moderato



Sa k'naqsi kur dëgjoj
valsin tonë në kët' pranverë.
Ai përs'ri po na fton
të vallzujm' si atëherë.

Bashk' me pranverën dhe ti lul'zon,
lule plot erë që në shpirt më gjallëron...

(refreni)

Vals o vals, ti jeho
mbi të bukurin atdhe!
Fushat tona i përshkon
ku shpërthen jet' e re...

Ne një vals na bashkoi
dhe na fali lumturin'.
Tingujt sot i ndëgjoj
dhe kujtoj prap rinin'.

Bashk' me pranverën dhe ti lulzon,
lule plot erë që në shpirt më
gjallëron...

(refreni).....

14. NJË VIZITË NË ATDHE

- Çka të vizitojmë më parë? – pyetën disa nxënës mysafirë.

- Unë them, Muzeun e Kosovës! – u propozoi nxënësve shqiptarë që jetonin në Gjermani dhe që kishin ardhur për pushime në atdhe. Dhe njëri pas tjetrit hynë ngadalë në Muzeun e Kosovës.

Arsimtari i tyre e pyeti Gentin:

- Çka të bëri përshtypje Gent?

- *Hyjnesha në fron*, arsimtar! - u përgjigj Genti.

- Ashtu?

- Po, sepse ajo përveç se është një figurinë e bukur, është edhe simbol nga Dardania Antike dhe tashmë është bërë simbol i qytetit të Prishtinës.

- Të lumtë!

Pastaj grupi vendosi ta vizitonte Muzeun Etnologjik të Kosovës. Shumë nga nxënësit as që dinin se çfarë ishin objektet që ishin prezantuar aty: armë, veshje, arka, elemente etnografike të shumta. Por ishte ciceroni ai që ua shuante etjen me përgjigje për gjithçka që atyre u interesonte.



Pamje e një dhome të një shtëpie tradicionale qytetare shqiptare

- Po nesër? - pyeti arsimtari, pasi ishte kryer vizita në Muzeun Etnologjik.
- Nesër do ta vizitojmë Shpellën e Gadimes, se dua t'i shoh stalaktitet dhe stalagmitet që janë si Romeo e Xhulijeta, - u hodh Mara.

- Unë dua t'i shoh Bjeshkët e Rugovës, - kërceu Drini.
- Unë dua ta shoh Urën e Fshejtë.
- Unë Ujëvarën e Mirushës.
- Unë them të shkojmë sonte në teatër.
- Unë them të shkojmë në kinema!
- Po koncertin e nesërm në Pallatin e Rinisë, nuk do ta ndjekim?
- Uaaaa! - ia bëri arsimtari.- Do t'i vizitojmë të gjitha, vetëm kini durim. E shihni se Kosova ka shumëçka që duhet vizituar e duhet njohur.



Liqenet e Mirushës

Mendo!

1. Çfarë do të zgjedhje të vizitosh së pari në atdhe?
2. Përse mund të jetë interesante Shpella e Gadimes?
3. A preferon të vizitosh më shumë kinemanë apo muzetë? Pse?
4. Çka keni dëgjuar për Shpellën e Gadimes apo për Ujëvarat e Mirushës?

Puno!

Bashkë me shokët e grupit skico një guidë turistike të shkurtër për pasuritë turistike, kulturore dhe natyrore të Kosovës!



Shpella e Gadimes



Detyra

1. Bëje një vizitë imagjinare në Kosovë në vendin që dëshiron!
2. Tregoje gojarisht para shokëve vizitën tënde imagjinare në Kosovë!
3. Pikturo skena e imazhe me motive nga vendlindja apo bëj një pllakat me fotografi etj. për Kosovën turistike!

Gërmia

PUNA, KOHA E LIRË DHE MEDIAT

15. TRURI ELEKTRONIK

Truri elektronik është aq i vogël, sa mund të qëndrojë në majën e një gishti, por është protagonist i vërtetë i revolucionit të sotëm që po bëjnë kompjuterët. Ai ka hyrë në çdo shtëpi, në çdo zyrë, në çdo objekt: i gatshëm, i gjendshëm, i pagabueshëm. Është një "shërbyes i bindur e besnik" i njeriut, kur ai ka nevojë.

Një, vetëm një prej këtyre "trurëve elektronikë" të vegjël është në gjendje të vërë në funksionim një aparat të madh, ta mësojë orën tënde të dorës të të tregojë kohën me saktësi, ose të lejojë njërën prej lojërave të tua elektronike të mënjanojë të gjithë armiqtë ose kundërshtarët.


Më tepër se një milion të dhëna mikroskopike janë fiksuar mbi sipërfaqen e pllakave të këtyre kutive prej silici.

Shtrohet pyetja: si janë ndërtuar këto mrekulli elektronike? Në qoftë se do të vëzhgojmë në mikroskop një foto të këtyre pllakave, që ndryshe quhen me emrin "çip" (chip), do të vëmë re se ato janë të përshkruara nga shumë "shtigje elektronike", që u ngjajnë rrugëve e rrugicave të shumta që vihen re në hartat e qyteteve të mëdha.

Të projektosh një "chip" është një ndërmarrje e madhe dhe mjaft komplekse. Disa do të thoshin: Shumë e ngatërruar!

Përkundrazi. Aty ka një rregullësi të përsosur. Çdo gjë është në vendin e vet. Para së gjithash vijnë vizatimet, të cilat bëhen me një kompjuter special, që është shumë i përshtatshëm për këtë punë. Këto vendosen mbi "fushën e çipit". Çdo linjë mbi video të kompjuterit është një kanal që urdhëron një veprim të caktuar elektronik. Teknika e saj mund të themi se është pa fund, ashtu siç janë edhe punët që kryhen.

Ne gëzojmë të mirat e trurit elektronik. Shkencëtarët e kanë shpikur atë për të mirën e njerëzimit, për t'ua lehtësuar njerëzve punët e shumta mekanike.



Detyra

1. Sa e përdor kompjuterin gjatë ditës?
2. Cilat programe i përdor për punë?
3. Çfarë punësh kryen me kompjuter?
4. Sa e përdor kompjuterin për punë?
5. Sa kohë e përdor për argëtim?
6. Cilat programe i përdor për argëtim?
Pse të pëlqejnë ato programe?





Diskutoni në grup!

1. Çka do të thotë për njerëzimin zbulimi i kompjuterit?
2. Paraqitni njëherë mendimet tuaja individuale!
3. Merrni shënime rreth qëndrimeve të shokëve të tu!
4. Ballafaqoni mendimet tuaja me njëri- tjetrin!
5. Kompjuteri është bërë shumë i fuqishëm dhe i domosdoshëm në botën tonë
6. Përfytyroni dhe diskutoni pasojat sikur prej nesër të gjithë kompjuterët nuk do të punonin më! Çka do të ndodhte në një botë pa kompjuterë?

Detyrë shtesë

- Shkruani mendimin tuaj për rëndësinë, zbatueshmërinë, përhapjen, përdorimin dhe për të gjitha të mirat, për ndryshimet dhe eventualisht për të këqijat që i ka sjellë kompjuteri njerëzimit!



16. VEGLAT SOFTUERIKE PËR INTERNET

Veprat (anglisht **tools**) softuerike na mundësojnë të jemi më produktivë në punën tonë me kompjuterë. Ato na mundësojnë që t'i bëjmë me lehtësi të madhe shumë veprime tejet komplekse.

Shumë punë është duke u bërë në kohë të fundit për krijimin e veglave të ndryshme softuerike për ta lehtësuar punën me internet. Kompanitë e ndryshme prodhuese të softuerit janë duke bërë gara se cila ofron vegël më të fuqishme e njëkohësisht më praktike dhe të thjeshtë për përdorim (user friendly). Një veçori tjetër e rëndësishme, sipas shfrytëzuesve amerikanë, është që vegla të jetë jo vetëm e thjeshtë, por edhe e këndshme për përdorim. Në reklama për softuer shpesh do të hasni në fraza sikur kjo:

” Ju do të keni kënaqësinë që të zbatimeni me programin tonë...etj.”

Konkurrenca është aq e madhe dhe e pamëshirëshme, saqë edhe kompanitë më të mëdha si p.sh. Microsofti, janë të detyruara t'i përmirësojnë vazhdimisht prodhimet e veta, sepse në të kundërtën, shumë shpejt mund të mbeten pa blerës. Dy paketa softuerike (me shumë vegla të ndryshme brenda), që sot mund t'i gjejmë në treg janë Netscape Communicator dhe MS Internet Explorer në versionet më të reja.

Të shohim tash se cilat janë veglat më kryesore për punë me shërbimet e ndryshme të Internetit.

Puna e parë, që zakonisht do të bëjmë, pasi të lidhemi në internet, është të shohim si çka ka aty. Veprimi që mundëson hulumtimin e informacioneve nëpër internet në anglisht quhet browsing, ndërsa vegla përkatëse që e bënë këtë punë quhet browser (brauzer). Në fjalorin anglisht – shqip të Stuart E. Mannit, për këtë fjalë, përveç të tjerash, gjeta një përkthim shumë simpatik browse (brauz), kafshoj gjethe, ushqehem me gjethe ose figurativisht endem duke kafshuar aty-këtu! Kjo e fundit më pëlqeu posaçërisht, pra brauzing qenka: Endem nëpër Internet duke kafshuar aty-këtu ndonjë informacion!

Ta lëmë humorin anash, është me rëndësi se e kemi kuptuar esencën. Sa i përket kësaj çështjeje do të shtoja vetëm se ekzistojnë mënyra të ndryshme të hulumtimit të informatave të ndryshme në internet. Mënyra më e thjeshtë është kur e dimë adresën e burimit konkret të informacionit, që në terminologjinë e internetit quhet web (ueb), site (sajt) e ndonjëherë edhe website (uebsajt). Kjo adresë është në formë të një fjale karakteristike për burimin e informatës, p.sh adresa e sajtit të *Rilindjes* është www.rilindja.com.



Posta elektronike, (angl. **E-mail**) është një shërbim shumë i rëndësishëm i internetit. Informacionin në formë të një fajlli (file), që përveç tekstit, mund të përmbajë edhe imazhe grafike apo informata afariste të ndryshme, mund t'ia dërgojmë cilitdo parapagues të internetit. Për më tepër, këtë informatë mund ta dërgojmë edhe nëse kompjuteri në anën e marrësit nuk është fare i aktivizuar! Ai, në këtë rast do ta marrë postën atëherë kur e aktivizon kompjuterin e vet.

Një shërbim tjetër i popullarizuar në internet është **diskutimi rreth ndonjë teme** në forume të ndryshme, ku mund të marrë pjesë kushdo, duke i shprehur mendimet e veta dhe duke luftuar mendimet e kundërshtarëve. Një shembull i shkëlqyeshëm për këtë është lufta e vërtetë informative që janë duke e bërë me shumë sukses dhe me përkushtim një grup të rinjsh entuziastë shqiptarë lidhur me çështjen e Kosovës (aktiviteti bëhet duke i shfrytëzuar aplikacionet e posaçme të quajtura: menaxheri i diskutimit në grup (anglisht: group discussion manager).

Me internet mund të organizohen edhe konferenca të drejtpërdrejta. Paramendoni sa kursime do të kishte një kompani multinacionale që mbledhjet e drejtorëve të kompanive të veta anembanë botës i organizon pa shpenzime të udhëtimit dhe pa humbje kohe. Mjafton që këta në kohë të caktuar të ulen pranë kompjuterit dhe të nisin konferencën. Kjo punë bëhet me ndihmën e aplikacioneve të quajtura: vegla për konferencë të drejtpërdrejtë (anglisht: live conferencing tool).



Dhe në fund, nëse duam të prezantojmë diçka në internet, atëherë për këtë duhet përdorur editorët e faqes prezentuese Web (anglisht: Web page editor). Me ndihmën e kësaj vegle bëhet disenjimi i faqes prezentuese ashtu që të jetë sa më praktike për përdorim, shfletim dhe njëkohësisht sa më estetike dhe tërheqëse për "vizitorët" e ndryshëm.

Agron S. Dida

Punë në grup

- Diskutojini përvojat tuaja në përdorimin e veglave softuerike për internet! Cilat vegla i përdorni, për çka dhe me cilat përvoja?
- Bëni një tabelë me veglat e ndryshme dhe me të mirat e të metat e tyre!

Detyrë:

1. Shkruaj cilat vegla softerike i përdor më së shpeshti dhe pse!
2. Shkruaj adresën e së paku pesë web-faqeve që ua rekomandon edhe shokëve e shoqeve! Arsyeto pse!
3. Trego shkurtimisht për çka dhe si i përdor ti ato web-faqe?
4. Paraqiti listën dhe shënimet e tua për grupin!

Detyrë për gjithë grupin

- Bëni një listë me web-faqet më të rëndësishme për komunikim, për informim, për mësim dhe për lojë e argëtim, të cilat mendoni se janë me interes të veçantë për çdo përdorues interneti, për çdo të ri, a të re!

17. TË RINJTË DHE INTERNETI

Reflektimet e Arditës 14-vjeçare rreth Facebook-ut, blog-ut, dhomave të bashkëbisedimeve në internet etj.



Në ditët e sotme interneti është një ndër gjërat më të rëndësishme për të rinjtë. Sot kemi shumë faqe interneti dhe mundësi të ndryshme komunikimi me shoqërinë të cilën nuk e kemi afër. Sipas mendimit tim, disa mundësi komunikimi përmes internetit, si Facebook, blog-u apo dhomat e ndryshme të bashkëbisedimeve kanë anë pozitive dhe negative. Facebook-u dhe blog-u janë mundësi të mira komunikimi me njerëz të tjerë dhe nëpërmjet këtyre faqeve mund të bisedosh dhe të jesh i informuar për shumë gjëra që u ndodhin "miqve dhe shokëve

të internetit" apo të të afërmeve që ndodhen gjithandej në vende të ndryshme të botës. Mirëpo e keqja është se ndodh që të rinjtë bisedojnë edhe me njerëz të panjohur, që mund të jetë e rrezikshme dhe jo shumë e preferuar. Mund të keqpërdoren sidomos fotografitë, madje edhe duke bërë montazhe të ndryshme. Komunikimi nëpërmjet internetit është gjë e mirë, mirëpo qëndrimi i tepërt në internet është një humbje kohe dhe ndikon keq gjithashtu në shëndet. Një përdorim i internetit prej dy ose tri orësh në ditë është i mjaftueshëm, në qoftë se përdoret për qëllime të mira. Në shoqërinë tike ka shumë persona, të cilët nuk kanë një orar të kufizuar qëndrimi në internet; ndodh që të qëndrojnë deri me 10 orë ose më shumë pranë kompjuterit. Kështu, ata janë shumë të lodhur, nuk janë të aftë t'i përballojnë mësimet në shkollë apo aktivitetet e lira dhe bëhen viktimë e internetit. Facebook-u dhe blog-u janë faqe interneti të cilat unë i përdor me rezervë, sepse të marrin shumë kohë.

Edhe ueb kamera, ndonëse është shumë e përshtatshme për komunikim me të afërmit, duhet të përdoret me kujdes e me maturi, sepse xhirimet e saj mund të keqpërdoren po ashtu.



Detyra

1. Si komunikon nëpërmjet internetit (Chat, Mail, Facebook, Skype...)? Bëje një listë!
2. A ke blog dhe Facebook personal?
3. Cilët i pranon si miq komunikimi në Facebook? Arsyeto qëndrimin tënd!
4. Çka mendon për qëndrimin e Arditës (në tekstin sipër) rreth të rinjve dhe internetit?
5. Shkruaj të mirat dhe të këqijat e këtij mjeti të rëndësishëm komunikimi!



Diskutoni në grup!

1. Numëroni të mirat që i kanë sjellë mundësitë e komunikimit elektronik njerëzimit!
2. Cilat janë të këqijat e mundshme të këtij komunikimi sipas teje?
3. Çka mendoni: Deri ku shkon kufiri në mes asaj që është personale dhe asaj që është për opinionin e gjerë?
4. Shkruaj në një anë të mirat dhe në anën tjetër të këqijat që i ka sjellë ky mjet komunikimi njerëzimit! Bëni një tabelë për të mirat e të këqijat!

Të mirat

Të këqijat

Debatoni!

Formoni dy grupe. Bëni një debat rreth Facebook-ut, blog-ut, dhomave të bashkëbisedimeve në internet etj., duke sjellë argumente **për** dhe **kundër** përdorimit të atyre mjeteve të komunikimit! Mund të caktoni njërin/njëren prej jush si “moderator” të debatit.



18. NE DHE TELEVISIONI

Nuk ka dyshim se televizori ndihmon ta njohim më mirë botën. Shtrohet pyetja: Sa kohë mund të ndjekë fëmija programin televiziv?


Gjysma e zhvillimit të përgjithshëm të aftësive mendore të njeriut zhvillohet gjatë katër viteve të parë të jetës, tridhjetë për qind ndërmjet moshës katër dhe tetëvjeçare, kurse njëzet për qind të ardhshme ndërmjet moshës tetë dhe shtatëmbëdhjetëvjeçare.

Nga hulumtimet ka dalë se fëmijëve deri në moshën shtatëvjeçare nuk u lejohet të ndjekin programin televiziv më shumë se gjysmë orë në ditë, madje jo më shpesh se dy-tri herë në javë.

Gjithashtu duhet të dini si t'i zgjidhni emisionet, por edhe pozitën, sepse pozita e padrejtë shprehet dëmshëm në zhvillimin e organizmit të fëmijës.

Largësia nga televizori nuk bën të jetë më pak se dy deri pesë-gjashtë metra. Ekranin duhet vendosur në nivel të syve ose pakëz më poshtë. Programi nuk duhet shikohet në terr të plotë, duhet ndriçuar pakëz dhomën, ashtu që forca e dritës së ekranit të jetë e barabartë me dritën e dhomës.

Do thënë, po ashtu, se kur fëmija, ta zëmë, e dëgjon apo e lexon një përrallë, imagjinata e tij është aktive, shumë e nevojshme për zhvillimin e personalitetit. Të shikuarit e programit televiziv ofron shumë mundësi për njohjen e gjërave të reja, por më pak se libri krijon aftësinë e të menduarit logjik, sepse të gjitha gjërat i bie në formë të kryer, të gatshme. Preferohet që pas emisionit të diskutohet medoemos me fëmijët përkitazi me atë që kanë shikuar. Edhe shumësia e informatave është e dëmshme. Prandaj bashkë me fëmijët pranë televizorit duhet të jenë edhe prindërit – si timonierë të informatave, ndihmës të pjekurisë natyrore dhe intelektuale të fëmijës.



Diskutoni në grup!

1. Nga sa orë në ditë e shikoni TV-në?
2. Në cilën gjuhë shikoni TV-në shqip apo atë të vendit ku jetoni? Pse?
3. A keni orar të caktuar për ta shikuar TV-në?

Detyra

1. Cili është programi yt i preferuar argëtues televiziv?
2. Shkruaj cili është koncepti i atij programi, çka ndodh në të zakonisht?
3. Pse të tërheq aq shumë ta shikosh atë program?



Punë në grup

1. Merreni videokamerën e shkollës ose ueb kamerën e kompjuterit dhe improvizoni një studio televizive. Zgjidheni njërin/njërën prej shokëve si udhëheqës programi. Përcaktojeni temën e programit debatues. (P.sh. *Barazia gjinore* ose *Puna dhe koha e lirë.*)!
2. Pjesëmarrësit në programin e improvizuar le të jenë shoqet dhe shokët tuaj.
3. Mos harroni t'i argumentoni qëndrimet tuaja!
4. Mblidhni disa argumente **për** dhe **kundër** rreth qëndrimit tuaj për këtë temë!
5. Debatoni pastaj duke e xhiruar gjithë bisedën që mund të zgjatë nja 20 minuta. Pastaj bashkë me arsimtarin/en e gjuhës shqipe shikojeni këtë program të improvizuar dhe diskutoni rreth tij!
6. Analizoni pastaj argumentimin e fakteve dhe kundërargumentimin e secilit duke mbajtur shënime!



19. REKLAMA DHE NXITJA

Çdo ditë mesatarisht rreth gjashtë orë i kalojmë në shoqëri me masmediat.

Me disa nga to jemi në shoqëri më gjatë dhe me disa të tjera më shkurt. Mediat janë: radioja, televizioni, interneti, teksti televiziv, videoja, gazetat ditore e periodike, revistat, librat, CD-të, DVD-të, mp3, mp4, I-phone etj. Të gjitha këto masmedia shpeshherë përdoren nga organizata punuese, të shërbimeve e të prodhimeve si medime më të përshtatshme për përhapjen e reklamës dhe të nxitjes për konsumimin e prodhimeve dhe të shërbimeve të ndryshme. Prandaj, sa i përket nxitjes dhe reklamës, duhet të jemi shumë të kujdesshëm gjithmonë rreth qëllimit, pse dhe kujt i bëhen ato!

Shembull

Para se të nxjerrim në treg prodhimin tonë, duhet të kemi studiuar mirë tregun dhe të kemi përcaktuar karakteristikat e tij dhe rrugët e shpërndarjes së tij. Pra është shumë e rëndësishme mënyra se si të bëjmë të njohur prodhimin te klientët tanë të ardhshëm me anë të dokumenteve si katalog, oferta, reklama, zbritje çmimesh etj. Këtë gjë do ta bëjmë nëpërmjet reklamës dhe të nxitjes.

Reklama

Synimi i reklamës është të bëjë të njohur prodhimin, që ai të shitet.

Krahas shtypit, reklamën mund ta realizojmë edhe me rrugë të tjera, si nëpërmjet vendosjes së shpalljes në vende të dukshme, shpërndarjes së fletëve me informacionin përkatës, si dhe me anën e veturave me autoparlant ose edhe nëpërmjet internetit.

Nxitja

Prodhuesit, krahas reklamës, përdorin edhe nxitjen. Kjo do të thotë, për shembull, se gjatë një jave do të ketë ulje 20% të çmimit, ose në qoftë se blini 10 lojëra, një artikull të jepet falas, ose ofrohet një artikull tjetër dhuratë bashkë me produktin etj. Pra, nxitja është një veprim, veç atij të reklamës, që synon të shtojë shitjet e një produkti.

Për të realizuar nxitjen duhet të kemi imagjinatë sa më të zhvilluar për t'i tërhequr klientët. Nxitja arrihet me shpërndarjen e modeleve, si p.sh. të lojërave, në konkurse të ndryshme, ekspozita, nëpërmjet lidhjeve telefonike, me letra etj. Ndërmarrjet e mëdha organizojnë fushata të rëndësishme reklame dhe nxitjeje, duke përdorur edhe shumë forma dhe mjete reklame dhe nxitjeje.



Rikujtoni!

Të bësh MARKETING do të thotë të përcaktosh prodhimin, të studiosh tregun, të realizosh shpërndarjen, të nxitet shitja e produktit.

Nuk mjafton të prodhohet një produkt të mirë, duhet të dimë gjithashtu ta shesim atë dhe të përcaktojmë një politikë të mirë të marketingut. Një produkt i mirë tërheq klientë të shumtë dhe krijon mundësi të mëdha për t'ia dalë mbanë e për të pasur rezultate të mira të shitjes. Kjo mundëson ndërmarrjen që të fitojë para, të zërë me punë punonjësit e saj dhe t'i shpërblejë ata më mirë.

Bisedoni së bashku!

1. Në cilin kuptim dallohet reklama nga nxitja?
2. Renditni mjetet e reklamës duke filluar nga ato që i quani më të efektshme, deri tek ato më pak të efektshme: shtypi i përditshëm e periodik, radioja, televizioni, kinemaja, interneti...
3. Komentoni shprehjen: "Malli i mirë shet veten"!
4. Çfarë efekti ka caktimi i çmimeve të lira te blerësi? Po te shitësi?
5. Çfarë efekti ka te blerësi dhe te shitësi caktimi i çmimeve të tilla: 29.99 € për një palë këpucë, 149.99 € për një kostum, etj.?

Detyra:

1. Sa janë të besueshme reklamat dhe nxitja për ty?
2. Shkruaj të mirat dhe të këqijat që vijnë nga reklama dhe nxitja në masmedia?
3. Cilat janë mediat e tua të preferuara; cilin rol luajnë në to reklama dhe nxitja?

Diskutoni në grup!

1. Numëroni stërmadhimet e disa reklamave dhe nxitjeve!
2. Cilave reklamave dhe nxitjeve ju besoni, cilave jo – dhe pse? Arsyetoni qëndrimet tuaja!
3. Bëni një tabelë, shkruani të mirat dhe të këqijat e reklamave dhe të nxitjeve!

Imagjinoni sikur keni një organizatë prodhuese dhe doni të reklamoni prodhimet tuaja!

1. Formuloni një reklamë për TV, radio, gazeta apo për faqe interneti për prodhimin tuaj! Bëjeni në formë të një pllakati ose të një ueb sajt!
2. Diskutoni pastaj në grup reklamat tuaja! Sa kanë qenë ato tërheqëse, sa kanë qenë nxitëse dhe sa përkojnë me realitetin, me cilësinë e përdorimit e prodhimit tuaj!

20. SHQETËSIMET E NJË NXËNËSEJE

Shumë prindër nuk i dërgojnë fëmijët e tyre për të mësuar gjuhën shqipe. Ky duhet të jetë një shqetësim i madh për çdokë. Gjuha është mbi të gjitha, është çelësi i diturisë. Ajo errësirën e bën dritë, natën e bën dritë. Ajo është e ardhmja e kombit. Them me keqardhje se shumë fëmijëve na ka përcjellë fati i zi i prindërve tanë dhe pa dëshirën tonë kemi ardhur këtu në mërgim. E zvogëluam numrin e nxënësve në shkollat e vendlindjes. Ato sikur qajnë për ne, e kuptohet edhe ne qajmë për to. Si të mos qajnë ato kur me vite abetaret presin të hapura e bangat janë të zbrazëta... Dhe ne erdhëm në mërgim. Gjetëm shkollat në gjuhë të huaj, por fatbardhësisht gjetëm edhe gjuhën shqipe. Një fatbardhësi për ne, por me një të zezë në mes: fëmijët e diasporës janë të ndarë më dysh! Dhe janë prindërit tanë që na ndajnë më dysh: Prindërit e fëmijëve të grupit të parë, gjuhën shqipe e shohin si të nevojshme, bile edhe të domosdoshme, ndërkaq prindërit e grupit të dytë, nuk e shohin të arsyeshme t'i dërgojnë fëmijët e tyre në gjuhën shqipe, duke menduar se



s'kanë nevojë për një lëndë të tillë, meqë mësojnë në gjuhën e vendit ku jetojnë dhe se gjuha shqipe i penguaka në shkollën e huaj! Prindërit që nuk i dërgojnë fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën shqipe, herët a vonë do të përgjigjen para dikujt... Para fëmijëve të tyre gjithsesi.

Prandaj ne fëmijët ua tërheqim vërejtjen në mënyrën më serioze: Ju, të dashur prindër, që nuk na krijoni kushte për gjuhën shqipe, vënia gishtin kokës, kthjelloni mendjen tuaj të turbulluar dhe dërgoni fëmijët tuaj të mësojnë edhe gjuhën shqipe sepse ajo nuk do t'i pengojë ata, përkundrazi, do t'u ndihmojë shumë, shumë... Ata që do ta mësojnë bukur gjuhën e tyre do t'i mësojnë shumë më mirë edhe gjuhët e huaja. Kjo tashmë është vërtetuar nga shumëkush...

Shqipja, nxënëse e klasës së tetë

- Gjuha është mbi të gjitha, është çelësi i diturisë.
- Ajo errësirën e bënë dritë, natën e bënë dritë.
- Ajo është e ardhmja e kombit.
- Ata, që do ta mësojnë bukur gjuhën e tyre, do t'i mësojnë shumë më mirë edhe gjuhët e huaja.
- Prindërit që nuk i dërgojnë fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën shqipe, herët a vonë do të përgjigjen para dikujt... Para fëmijëve të tyre gjithsesi.

Pyetje dhe detyra

- A e kupton shqetësimin e Shqipëse? Çka të duket e kuptueshme, çka ndoshta jo aq?
- Cili është roli i prindërve për përfshirjen e nxënësve në mësimin plotësues aty ku jetoni?
- A mund të bësh diçka më tepër për këtë çështje?
- Nëse po, trego çka, si dhe sa!
- Nëse jo, trego cilat janë pengesat që nuk të lejojnë që ti bashkë me shokë e shoqe të bëni më shumë për mësimin e gjuhës shqipe në shkollën ku mësoni në vendin ku jetoni!

Punë në grup

1. Bashkë me shoqe e shokë bëni një plan konkret se si mund ta përmirësoni përfshirjen e sa më shumë nxënësve në mësimin e gjuhës amtare!
2. Kërkoni pastaj ndihmën e mësuesit/e mësueses së shkollës dhe të prindërve në realizimin e planit tuaj!
3. Bëni pas një periudhe të caktuar një analizë të realizimit të planit tuaj! Shkruani a ia keni arritur qëllimit të paraparë!

Detyra shtesë

1. Shkruaj një artikull për një shqetësim që të mundon gjatë përditëshmërisë!
2. Artikullin që e ke shkruar lexoje para shokëve/qeve dhe diskutojeni së bashku!
3. Lexojeni edhe para mësuesit/es dhe kërkoni nga ai/ajo t'ju japë vërejtjet e mendimet dhe ta redaktojë gjuhësisht!
4. Pastaj mund ta dërgosh artikullin për botim në ndonjë gazetë.



Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj
PUNA DHE KOHA E LIRË

Fletore tematike - për nivelin e tretë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në shkurt 2013

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18:37(0761)

008(=18)

Sheqiri, Rizah

Puna dhe koha e lirë: fletore tematike për nivelin e tretë /

Rizah Sheqiri, Nexhat Maloku, Lush Culaj. – Botimi i parë.

- Pejë: Dukagjini, 2013. - 48 f.: ilustr. me ngjyra; 29 cm.

1. Maloku, Nexhat 2. Culaj, Lush

ISBN 978-9951-05-260-3

Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,

të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 2-3774, të datës 17.10.2012